



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 945/P prot.

Vlorë, më 23.07.2018

**VENDIM**

Nr. 43, datë 12.07.2018

**PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË MASËN 20 PËR QIND NË PROGRAMIN  
"BACHELOR NË INXHINIERI ELEKTRIKE"**

Mbështetur në pikën 9 të nenit 35, shkronjën **dh** të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 12.07.2018

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave Teknike për ndryshime në programin "Bachelor në inxhinieri elektrike" në masën 20 për qind (36 kredite).
2. Ky program studimi do të zbatohet për vitin akademik 2018-2019.
3. MASR do të njoftohet me shkrim për ndryshimet e bëra në këtë program studimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

Prof. Dr. Roland ZISI

